

SONILA BOÇI

**MINORITETI GREK NË SHQIPËRI MIDIS REZISTENCËS
SHQIPTARE DHE ASAJ GREKE
(1942-1944)**

Historia e organizimit të rezistencës në minoritetin grek është trajtuar në mënyrë periferike nga studiuesit shqiptarë dhe gjithmonë në funksion të marrëdhënieve shqiptaro-greke. Ndërsa, historianët grekë janë më aktivë në trajtimin e kësaj çështjeje. Disa prej tyre, të ndikuar edhe nga politika, e kanë konsideruar shtetin shqiptar si pjesë të Boshtit nazifashist dhe kanë mohuar rezistencën e popullit shqiptar në Shqipëri, duke i etiketuar të gjithë shqiptarët si bashkëpunëtorë të pushtuesve. Këta studiues përpiqen të argumentojnë se në të vërtetë në Shqipërinë e Jugut ka qenë zhvilluar vetëm “rezistenca e vorio-epirotëve” ndaj pushtuesve italianë e gjermanë dhe bashkëpunëtorëve të tyre shqiptarë¹ dhe jo “rezistenca shqiptare”. Autorët grekë arrijnë në këtë “përfundim” edhe për shkak të konceptit të gabuar të tyre për shtrirjen dhe numrin e minoritetit grek në Shqipëri². Ndërkohë që ka të tjerë historianë grekë,

¹ Në lidhje me konceptet greke për rezistencën kundër pushtuesit e të ashtuquajturve Vorio-Epirotë shih: Σπυριδών Πλουμίδης, *Το βορειοηπειρωτικό ζήτημα στα πλαίσια της βρετανικής πολιτικής και των ελληνοαλβανικών σχέσεων την περίοδο της ιταλογερμανικής κατοχής (1941-1944)*, [Spiridon Plumidis, *Problemi vorioepirot në kuadrin e politikës britanike dhe marrëdhënieve greko-shqiptare në periudhën e pushtimit italo-gjerman (1941-1944)*], në: “Ιστορ”, 13 (2002), f. 77-105 si dhe Ruches, Pyrrhus J., *Albania's Captives*, Argonaut Publishers, Chicago, 1965, f. 154-155.

² Pjesa më e madhe e studiuesve grekë konsiderojnë si minoritet grek në Shqipëri të gjithë të krishterët ortodoksë të Shqipërisë së Jugut. Ky perceptim i gabuar vjen për shkak të konceptit mesjetar i përdorur më vonë dhe nga qarqet politike greke se besimi fetar është një nga elementët bazë përcaktues të kombësisë. Qeveria greke duke u mbështetur në këtë koncept në mënyrë të vazhdueshme, që

pranojnë përfshirjen e minoritetit grek në krah të rezistencës antifashiste shqiptare³.

Po t'i referohemi dokumenteve shqiptare të viteve të Luftës së Dytë Botërore argumentohet më së miri se rezistenca kundër pushtuesve ishte më e fuqishme dhe më e organizuar në Shqipërinë e Jugut, dhe se peshën kryesore të saj e mbajtën krahinat shqiptare dhe popullsia shqiptare e Vlorës, Korçës, Gjirokastrës, Kolonjës etj.⁴

Ndërkohë dokumentet shqiptare pohojnë me korrektesë edhe përfshirjen e minoritetit grek në Shqipëri në rezistencën kundër pushtuesit italian dhe gjerman.

Lufta e Dytë Botërore pati karakter shumëdimensional. Sipas përcaktimit të historianit të mirënjohur anglez, Erik Hobsbaum, Lufta e Dytë Botërore ishte jo vetëm një luftë frontale e armatosur ndërmjet forcave ushtarake të dy blloqeve kundërshtarë, por edhe një luftë civile-ideologjike me karakter ndërkombëtar⁵. Një karakter i tillë i Luftës ndryshoi në një farë mase dhe karakterin e nacionalizmit. Duke qenë se shtetet pushtuese mbështeteshin në ideologjinë fashiste, lufta për çlirim kombëtar, veçanërisht pas hyrjes në Luftë të BRSS, mori edhe karakter antifashist⁶, gjë që do të thotë se dhe nacionalizmi i tyre mori këtë ngjyrim të ri. Partitë komuniste e lidhën luftën për çlirim kombëtar me luftën kundër ideologjisë fashiste. Kështu lindi një nacionalizëm antifashist, bartësit e të cilit u bënë komunistët. Për të mobilizuar shtresat e varfra të popullsisë, komunistët zhvilluan një propagandë të fuqishme dhe për ndryshime shoqërore dhe bashkimin e të gjithë punëtorëve, pavarësisht kombësisë së tyre. Ata përcaktuan kështu, si kundërshtarë të tyre, jo vetëm pushtuesin, por dhe shtresat e pasura të popullsisë, duke i dhënë nacionalizmit dhe karakter klasor.

nga viti 1844, nuk ka reshtur së konsideruari grekë të gjithë të krishterët e Shqipërisë së Jugut.

³ Evangelos Kofos, *Balkan minorities under communist regimes*, në: "Balkan Studies", vol. 2, nr. 1-2, 1961, f. 32.

⁴ Për më tepër për rezistencën shqiptare në vitet e para të pushtimit shih: Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian (1939-1943)*, Tiranë, 2005, f. 169-170.

⁵ Erik Hobsbaum, *Kombi dhe nacionalizmi që nga 1870-a: programi, miti, realiteti*, Shtëpia Botuese "Toena" dhe Fondacioni Soros, Tiranë, 1996, f. 146.

⁶ *Po aty*.

Grupet politike të djathta, për shkak të përbërjes së tyre sociale, nuk ishin të gatshme të bënin premtime për reforma shoqërore. Kjo shkaktoi ulje të ndjeshme të mbështetësve të tyre gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore⁷. Në këto kushte, të djathtët në Ballkan iu kundërpërgjigjën revolucionit shoqëror të komunistëve, duke theksuar në propagandën e tyre sidomos çështjen kombëtare⁸.

Në vjeshtë 1941 – pranverë 1942, në Greqi dhe Shqipëri filloi organizimi i rezistencës së armatosur kundër pushtuesit, e cila pati karakteristika të përbashkëta në të dy vendet: *Së pari*, forcat politike tradicionale, apo qeveritë legjitime nuk u treguan të afta për të organizuar qëndresë ndaj pushtuesit. Madje, disa nga njerëzit me influencë në qeveritë e paraluftës, vendosën të bëhen pjesë e administratës së pushtimit. *Së dyti*, fillimet e rezistencës kundër pushtuesit u organizuan nga forcat antimonarkiste dhe pas hyrjes në luftë të BS, edhe nga grupet komuniste, të cilat u treguan shumë aktive për tërheqjen e shtresave të ndryshme të popullsisë në rezistencën kundër pushtuesit⁹. *Së treti*, grupet e rezistencës, pavarësisht nga periudha të shkurtra bashkëpunimi nuk arritën të unifikohen.

Përfshirja e minoritetit grek në rezistencën kundër pushtuesit u konsiderua shumë e rëndësishme si për forcat shqiptare të rezistencës,

⁷ Fenomeni ishte i përhapur edhe në shtetet e Evropës Perëndimore. Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore në disa shtete të Evropës Perëndimore erdhën në pushtet parti, apo koalicione partish të majta. Tipik është rasti i Britanisë së Madhe, në të cilin Partia Konservatore e Churchillit, me gjithë popullarizimin e këtij të fundit gjatë viteve të LIIB, humbi zgjedhjet në favor të Partisë Liberale.

⁸ David H. Close, *Greece since 1945, politic, economy and society*, Longman Publishing Group, London, 2002, f. 11.

⁹ Në shtator 1941 në Greqi u krijua Fronti i Çlirimit Kombëtar (EAM), i cili brenda një kohe të shkurtër u vu nën drejtimin e PKG. Forca e armatosur e EAM ishte Ushtria Demokratike Greke (ELAS). Në nëntor 1941 u krijua forca e armatosur e EDES, me komandant Napolon Zervas, Lidhja Republikane Kombëtare Greke, e cila fillimisht mblodhi të gjithë elementët antimonarkistë. Shpejt kjo ushtri u mbështet dhe nga politikanë të qeverisë greke në mërgim, madje gjatë zhvillimit të luftimeve bëri marrëveshje me Mbretin e Greqisë, Jorgo II. Zhvillime paralele pati edhe në Shqipëri, ku më 16 shtator 1942 u krijua Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar (FNÇ), Partia Komuniste Shqiptare (PKSh) e krijuar në nëntor 1941 arriti të zinte pozita drejtuese në FNÇ. Në nëntor 1942, forcat e djathta antimonarkiste në Shqipëri krijuan një grupim tjetër të rezistencës, Ballin Kombëtar.

ashtu dhe për ato greke. Qëllimi ishte sa ushtarak, aq dhe politik. Qëllimet politike që i shtynin grupet e rezistencës greke e shqiptare të përfshinin minoritetin grek në rezistencën kundër pushtuesit ishin diametralisht të kundërta. Për grupet e rezistencës shqiptare përfshirja e minoritetit grek kishte rëndësi pasi ata ishin shtetas shqiptarë dhe pjesë integrale e shtetit shqiptar. Për forcat greke të rezistencës, arsyeja lidhej me pretendimet e tyre territoriale ndaj shtetit shqiptar. Rezistenca e minoritetit grek do të përdorej si parakusht për sigurimin e të drejtës së vetëvendosjes së minoritetit dhe e mbështetjes së ardhshme nga Aleatët për pretendimet greke ndaj “Epirit të Veriut”.

Minoriteti grek në Shqipëri midis EDES-it dhe EAM-it

Forcat greke të rezistencës ishin të parat që nxitën rezistencën kundër pushtuesve italianë në minoritetin grek. Më aktive në këtë drejtim ishte Lidhja Kombëtare Republikane Greke (EDES). Ajo mbështeste hapur pretendimet e qarqeve nacionaliste greke për të vendosur nën juridiksionin e shtetit grek të pasluftës Shqipërinë e Jugut, që ata e quanin Vorio-Epir. Për këtë arsye, EDES-i ishte i interesuar që rezistenca e minoritetit grek kundër pushtuesve italianë të shkëputej nga rezistenca shqiptare. Ajo duhet të organizohej nën flamurin “vorio-epirot”, apo nën atë grek, në mënyrë që pas Luftës, Aleatët të gjendeshin para faktit të kryer dhe të pranonin aneksimin e Shqipërisë së Jugut, Greqisë. Në mbështetje të këtij qëllimi, EDES-i u përpoq të shrinte ndikimin e tij jo vetëm në krahinat ku jetonte minoriteti grek, por në të gjithë popullsinë e krishterë të krahinave të Shqipërisë së Jugut, të pretenduara me kombësi greke nga qeveritë greke.

Në maj 1942, pothuajse në të njëjtën kohë me krijimin e formacioneve ushtarake të EDES-it në Greqi, u bënë përpjekjet e para në zonën e minoritetit grek për ngritjen e njësisë të rezistencës kundër pushtuesit italian. Dy oficerë të ushtrisë greke me prejardhje nga fshati Leshnicë e Poshtme e Delvinës¹⁰, Spiridhon Lito dhe Jani Videli u përpoqën të krijonin në to, një çetë të ashtuquajtur të rezistencës “vorio epirote”¹¹. Nuk ka të dhëna që çeta të ketë pasur ndonjë aktivitet gjatë vitit 1942 dhe në vazhdim. Në janar 1944, njëri nga themeluesit e saj,

¹⁰ Leshnica e Poshtme është fshat i Delvinës, ku jeton popullsi me kombësi greke.

¹¹ P. Ruches, *vep. e përm.*, f. 156.

Spirodon Lito u vra në afërsi të Prevezës, duke luftuar kundër gjermanëve në formacionet e EDES-it¹². Ka shumë mundësi të jetë shpërndarë.

Përpyekjet për të organizuar rezistencën në minoritetin grek, si dhe për ta shtrirë këtë rezistencë në gjithë zonën e “vijës Venizellos¹³”, vazhduan dhe më vonë. Në korrik 1942, nga një komision i përbërë prej minoritarësh grekë u krijua një organizatë e quajtur “Fronti i Çlirimit të Vorio Epirit” (MAVI)¹⁴. Midis themeluesve dallohen disa elementë grekë që ishin aktivizuar për organizimin e lëvizjes vorio-epirioete edhe gjatë periudhës midis dy luftërave¹⁵, si: Vasil Shahini, Mihal Mano¹⁶ etj. Qëllimi i kësaj organizate ishte të vihej në krye të rezistencës “greke” kundër pushtuesit italian në të ashtuquajturin Epir të Veriut. MAVI-a ishte e lidhur me shtabin e EDES-it dhe vepronte nën urdhrat e tij. Ajo u përpoq të shtrinte ndikimin e saj në të gjithë zonën e pretenduar nga qeveria greke, por pa ndonjë rezultat.

Si çeta e krijuar nga Spiridon Lito dhe Jani Vedeli, ashtu dhe MAVI-a, dështuan në projektin për të shtrirë veprimtarinë e tyre përtej zonës ku minoriteti grek jetonte me shumicë¹⁷. Drejtuesit dhe anëtarët e organizatave të sipërpërmendura e kishin prejardhjen nga fshatrat greqishtfolëse të Shqipërisë së Jugut. Madje, mbështetja e MAVI-së dhe në zonën e minoritetit grek nuk ishte e plotë për shkak të ndërhyrjes së krahut tjetër të rezistencës greke, EAM-it, si dhe grupeve shqiptare.

¹² *Po aty.*

¹³ *Vija Venizellos* është kufiri që ishte kërkuar nga Greqia në Konferencën e Londrës në janar 1913 dhe përfshinte territoret në jug të vijës Himarë-Korçë. Kjo vijë përfaqësonte kufirin e pretendimeve të qeverisë greke ndaj Shqipërisë në të gjitha periudhat. Madje dhe ushtria greke gjatë luftës italo-greke pushtoi vetëm territoret brenda kësaj vije. Kështu, në 22 nëntor 1940 pushtoi Korçën, më pas Pogradecin, Përmetin, në 6 dhjetor Sarandën dhe në 8 dhjetor Gjirokastrën.

¹⁴ Σ. Πλουμίδης, *vep. e përm.*, f. 96.

¹⁵ Lëvizja Vorio-Epirote në periudhën ndërmjet dy luftërave synonte krijimin e një krahine autonome në Shqipërinë e Jugut, si hap paraprak për aneksimin e mëvonshëm të kësaj krahine, shtetit grek. Drejtuesit e kësaj krahine ishin nacionalistë të skajshëm që ishin pjesë e minoritetit grek në Shqipëri, të cilët ishin shkolluar dhe shpesh paguar nga Greqia.

¹⁶ Kastriot Dervishi, *Shërbimi sekret shqiptar – historia nga fillimi deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2007 f. 166.

¹⁷ Sipas statistikave zyrtare të periudhës midis dy luftërave, minoriteti grek jetonte në masën dërmuese të tij në qarkun e Gjirokastrës, i cili përfshinte prefekturat e Gjirokastrës, Sarandës dhe Delvinës.

MAVI-a dhe EDES-i patën mbështetje në disa fshatra me popullsi minoritare si: Dhrovjan, Rrëza e Zezë, Pogoni etj, ku propaganda greke dhe në periudhën midis dy luftërave kishte qenë më e fuqishme. MAVI-a nuk arriti të krijonte një çetë të armatosur në asnjë nga zonat e pretenduara.

Sipas James Pettiferit, një “meritë” në dështimin e MAVI-së dhe EDES-it për tërheqjen e minoritetit grek në radhët e tyre kishin komunistët grekë dhe ata shqiptarë. Ata “mundën të ndalonin kontaktet midis minoritetit grek dhe andartëve të djathtë grek të Napoleon Zervës, të Epirit të Jugut, i cili kërkonte t’ia bashkëngjiste Epirin e Veriut, Greqisë”¹⁸. Rolin e komunistëve shqiptarë për të penguar planet e Napoleon Zervës në Shqipërinë e Jugut e pranon dhe studiuesi grek Spiridon Plumidis, por ai mendon se faktorët përcaktues për dështimin e Zervës në të ashtuquajturin “Epir të Veriut” janë dhe politika penguese e britanikëve dhe angazhimi i EDES-it në luftën civile që shpërtheu në Greqi¹⁹.

Pas dështimit të MAVI-së brenda territorit shqiptar dhe në vazhden e idesë së EDES-it për të veçuar rezistencën e minoritetit grek nga ajo shqiptare, shtabi i EDES-it, kërkoi ndihmën e misioneve britanike për të organizuar në Shqipërinë e Jugut rezistencë kundër pushtuesve italianë. Për një organizim të tillë, ai u kërkoi britanikëve 2000 sterlina, por ideja e N. Zervës nuk gjeti mbështetjen morale dhe financiare të tyre. Në vjeshtë të vitit 1943, duke parë se të gjitha përpjekjet për të ngritur njësi të rezistencës në Shqipërinë e Jugut të lidhura me EDES-in dështuan, Napolon Zerva, komandati i shtabit të EDES-it në Greqinë e Veriut, krijoi në jug të lumit Kalamas, brenda territorit grek, dy kompani me minoritarë grekë. Sipas Plumidis, numri i minoritarëve të rekrutuar në këto kompani kapte shifrën 600 minoritarë grekë, të cilët ishin rekrutuar në këto çeta “me shpresën se do të çlironin rajonet e tyre”²⁰. Kjo nënkupton se rekrutimi i minoritarëve grekë bëhej mbi baza vullnetare. Në dokumentet arkivore shqiptare nuk mund të arrihet në përfundime të sakta për numrin e minoritarëve të larguar në çetat e EDES-it. Por, nga ato mund të gjejmë mjaft njoftime se rekrutimi bëhej me pagesë. Në një raport të komitetit qarkor të PKSH së Gjirokastrës, për KQ të PKSH vihej në dukje se: “nga

¹⁸ James Pettifer, *The Greek minority in Albania in the aftermath of communism*, në: “The South Slav Journal”, vol. 22, Autumn-Winter, f. 17.

¹⁹ Σ. Πλουμίδης, *vep. e për.*, f. 98.

²⁰ *Po aty*, f. 99.

Dhrovjani dhe Leshnica kanë shkuar te Zerva 23 veta, mbasi ky paguan 1 stërlinë për tre anëtarë të familjes dhe gjysmë për qejfin e ushtarëve dhe kjo pagesë popullarizohet nga reaksioni²¹”.

Grupet e majta të rezistencës greke: EAM-i dhe ELAS-i ishin gjithashtu të interesuara për të përfshirë në anën e tyre minoritetin grek në Shqipëri. Në ndryshim nga EDES-i, EAM-i i drejtuar nga PKG ndiqte një politikë internacionaliste. Kjo nuk do të thotë se EAM-i ishte kundër pretendimeve territoriale greke, por kishte një linjë politike më të moderuar. EAM-i grek nuk mbështeste politikën e qeverisë greke në mërgim për t’i ngritur që gjatë Luftës së Dytë Botërore pretendimet për “Epirin e Veriut”. Ajo i qëndronte idesë se kjo çështje, duhej të zgjidhej pas luftës me votim popullor dhe jo me dhunë²². Ajo u kufizua në veprimtarinë e saj vetëm në zonat ku jetonte realisht minoriteti grek dhe jo në Shqipërinë e Jugut.

Territoret e kontrolluara nga EAM-i në Greqinë e Veriut ishin afër kufirit greko-shqiptar. Kjo i jepte mundësinë atij, të kishte kontakt më të shpeshta me zonat e populluara nga minoritarët grekë në kufirin shqiptar. Për këtë arsye, ndikimi i EAM-it në zonën e minoritetit, veçanërisht në krahinën e Dropullit ishte më i madh.

Për forcat politike të rezistencës shqiptare, përfshirja e minoritetit në rezistencë ishte një çështje më e komplikuar. Rezistenca e minoritetit veçanërisht atij grek, ashtu si dhe e minoriteteve të tjera në Ballkan, kishte karakteristika të veçanta. Minoriteti grek kishte një identitet të qartë kombëtar grek dhe ushqente ide irredentiste, të cilat nxiteshin fuqishëm nga Greqia. Asnjë nga forcat politike shqiptare nuk mund ta anashkalonte faktin se qëllimi i rezistencës së minoritetit grek ishte jo vetëm lufta për të çliruar krahinën e tyre, apo shtetin shqiptar, por edhe sigurimi i së drejtës të vetëvendosjes në fund të luftës, pra zgjidhja e asaj që ata e konsideronin si çështjen e tyre kombëtare. Në këtë këndvështrim, përfshirja e minoriteteve në luftë, veçanërisht e minoritetit grek duhej të bëhej e menduar dhe me kujdes duke shmangur të gjitha marrëveshjet apo premtimet, të cilat mund të rrezikonin integritetin territorial të shtetit shqiptar.

²¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi 14/Arkivi i Partisë (më tej: AP), strukturat, viti 1944, dos. 115, fl. 10. Letër e Komitetit qarkor të Gjirokastrës për KQ të PKSH, 14 maj 1944.

²² Σ. Πλουμίδης, *vep. e përm.*, f. 96.

Grupet e majta të rezistencës në Shqipëri nuk kishin ndonjë vijë politike të qartë ndaj minoriteteve. Në mbledhjen që themeloi PKSH, në 8-14 nëntor 1941, nuk ka të dhëna që të jetë diskutuar lidhur me qëndrimin që partia e sapokrijuar do të mbante ndaj tyre. Rezolucioni i Mbledhjes themeluese të PKSh dhe thirrja e PKSh, nuk fliste asgjë për pozicionin e saj ndaj çështjes së minoriteteve, por pranonte se ishte për vëllazërimin e popujve të Ballkanit në luftën e përbashkët ndaj okupatorit²³.

Në Konferencën e Pezës të mbajtur në 16 shtator 1942, gjithashtu nuk ka të dhëna të ketë pasur diskutime për politikën ndaj minoriteteve. Parullat e hedhura për “bashkimin e të gjithë shqiptarëve pa dallim feje, krahine dhe ideje”, si dhe për “Shqipërinë e lirë, të pandarëshme ...²⁴” shtruan nevojën për organizimin dhe shtrirjen e rezistencës shqiptare në të gjithë territorin shqiptar. Në këtë kuadër u bënë përpjekje për të shtirë pushtetin e këshillave nacionalçlirimtare dhe në fshatrat e minoritetit grek. Në vjeshtë 1942 dhe në pranverë 1943 u ndërmorën veprimtari konkrete për të tërhequr në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe minoritetin grek. Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar punoi për të ngritur këshillat antifashistë nacionalçlirimtarë në zonën e minoritetit dhe për të nxjerrë vullnetarë për çetat partizane. FNÇI i udhëhequr nga PKSH përdori disa mënyra për të tërhequr minoritetin, veçanërisht atë grek, në luftë përkrah lëvizjes së rezistencës shqiptare të krijuar nga ajo. Si punë përgatitore u përdor propaganda. Ajo synonte ta motivonte minoritetin grek, për t’u bashkuar me Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. Duke propaganduar se LANÇ-i po luftonte politikën përçarëse të pushtuesve italianë dhe bashkëpunëtorëve të tij vendas, në nëntor 1942, në një komunikatë në shtypin komunist të qarkut të Gjirokastrës fajësohej politika e fashizmit italian për kusarinë gjithnjë në rritje në zonën e minoritetit grek dhe në fshatrat e krishtera të qarkut të Gjirokastrës. Në mënyrë të qartë në komunikatë thuhet: “duke përfituar nga antagonizmat fetare dhe kombëtare të krahinës sonë, fashizmi ka mundur të organizojë më tepër se kudo gjetkë çeta hajdutësh, me qëllim ta përçajë popullin dhe ta dobësojë luftën nacionalçlirimtare. ... Qëllimi i organizimit të kësaj

²³ *Dokumenta themelore të PPSH (1941-1948)*, vëll. I, 8 Nëntori, Tiranë, 1971, f. 27.

²⁴ *Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacionalçlirimtar*, botim i Institutit të Historisë së Partisë pranë KQ të PPSH, Tiranë, 1962, f. 9-14.

hajdutërie në shkallë të gjerë është që të lindi mosmarrëveshje ndërmjet kristianit dhe myslimanit, ndërmjet shqiptarit dhe grekofonit dhe të pengohet bashkimi i tyre në luftë kundra fashizmit²⁵”.

Propaganda e komunistëve përpiquej të mos e ndante luftën kundër “pushtuesit fashist” me atë për ndryshime të thella shoqërore. Duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e popullsisë greke të Shqipërisë ishte ekonomikisht e varfër, komunistët i bënin thirrje të ngriheshin edhe ndaj korrupsionit në administratën shqiptaro-italiane të qarkut. Kështu, shtypi komunist i qarkut të Gjirokastrës njofton se në 30 nëntor 1942, një çetë kusarësh e shtytur nga Tahir Kolgjini²⁶, vodhi në Kakavijë 350 dhën nga të cilat 100 u shitën për llogari të prefektit dhe 25 për hesap të marshallit italian²⁷”. Pas kësaj, Lëvizja Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe PKSË i bënte thirrje popullit të minoritetit grek të organizohej për “mbrojtjen e armatosur së fshatit. Kusarët duhet të priten me plumb. Fshatarët duhet të lajmërojnë partizanët për çdo plaçkitje që u bëhet dhe bashkë me ta, të marrin pjesë në çfarosjen e tyre (kusarëve S.B.)²⁸”.

FNC organizonte kohë pas kohe fushata për shpërndarjen e ndihmave ekonomike në zonën e minoritetit. Njësitë partizane sulmonin repartet italiane, të cilat dërgoheshin për të mbledhur të dhjetën në zonën e minoritetit dhe ua kthenin bereqetin fshatarëve minoritarë grekë. Ky veprim i forcave partizane, i cili propagandohej gjerësisht në popull me anë të shtypit dhe trakteve komuniste, synonte të krijonte idenë e unitetit midis popullsisë greke dhe asaj shqiptare. Propaganda komuniste, duke njohur karakteristikat e veçanta të zonës minoritare i mëshonte dhe ndjenjave internacionaliste dhe idesë së vëllazërimit të popujve të Ballkanit kundër pushtuesve. Në shkurt 1943, njësi të ushtrisë partizane, në përpjekje për të nxjerrë sa më shumë partizanë nga zona e minoritetit, propagandonin se “lufta jonë është e lidhur me luftën e të gjithë popujve të tjerë që luftojnë fashizmin. Ne me luftën tonë ndihmojmë çlirimin e popujve të tjerë si dhe ata ndihmojnë çlirimin tonë. Kudo që gjendemi duhet të zbrazim armët tona kundra gjakësorëve fashista. Sa më shumë fashista do të vrasim aq më shpejt do të çlirohen popujt e robëruar²⁹”.

²⁵ *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-VIII-80, viti 1942. Komunikatë e FNC për qarkun e Gjirokastrës.

²⁶ Tahir Kolgjini u caktua prefekt i qarkut të Gjirokastrës nga shtatori 1942.

²⁷ *AIH*, A-VIII-80, viti 1942. Komunikatë e FNC për qarkun e Gjirokastrës.

²⁸ *Po aty*.

²⁹ *Po aty*.

Megjithatë deri në verë 1943, Lëvizja Antifashiste Nacionalçlirimtare nuk kishte mundur të depërtonte fuqishëm në radhët e minoritetit grek. Në minoritet nuk ishin formuar ende Këshillat Antifashistë Nacionalçlirimtarë dhe në zonë nuk vepronte asnjë çetë e armatosur partizane. Pas vizitë së Svetozar Vulmanoviç Tempos në qershor 1943 dhe hedhjes së idesë për një bashkëpunim më të gjerë midis grupeve të majta të rezistencës ballkanike, FNÇ lejoi emisarë të EAM-it në zonën e minoritetit grek. Ata i dhanë ndihmë të dukshme për të organizuar këshillat dhe për të tërhequr partizanë nga popullsia minoritare greke. Gjatë verës së vitit 1943, Fronti arriti të ngrinte këshillat e tij në zonën e minoritetit grek, si dhe të formonte, në gusht 1943, çetat territoriale të Vurgut dhe të Dropullit.

Nacionalistët shqiptarë, veçanërisht udhëheqësit e Ballit Kombëtar, i cili e shtrinte veprimtarinë e tij gjerësisht në zonën jugore të Shqipërisë, fillimisht bënë shumë pak përpjekje për të përfshirë në rezistencë minoritetin grek. Deri në verë 1943, marrëdhëniet midis minoritetit grek dhe Ballit Kombëtar ishin disi të ftohta dhe ky i fundit nuk kishte mundur të depërtonte në fshatrat ku jetonte minoriteti grek, si: në Dropull, Rëzomë të Delvinës, apo fshatrat minoritare të Sarandës. Mendoj se ka disa arsye për këtë: Balli Kombëtar doli në skenën e rezistencës shqiptare si një organizatë me një program të qartë nacionalist dhe më kërkesën e qartë për Shqipërinë etnike³⁰. Parulla e tij “Shqipëria e shqiptarëve” mund të ketë shkaktuar tek minoriteti grek hezitim dhe mosbesim ndaj Ballit Kombëtar. Nga ana tjetër, siç u përmend më sipër, në minoritetin grek kishte një ndikim të dukshëm EAM-i grek, i cili për shkak të afërsisë ideologjike ndihmonte Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe kundërshtonte punën e Ballit Kombëtar në popullsinë greke të Shqipërisë. Edhe EDES-i dhe qeveria greke në mërgim, i ndruheshin ndikimit të Ballit Kombëtar në zonën e minoritetit. Madje, kjo e fundit bëri gjithçka që mundej për të ndaluar Ballin Kombëtar të shtrinte veprimtarinë e tij në zonën e minoritetit grek.

Gjatë pranverës 1943, qeveria greke në mërgim akuzoi disa herë çetat e rezistencës shqiptare se “kishin ndërmarrë një fushatë terrori kundër popullsisë greke të Epirit të Veriut³¹”. Ajo ngrinte shqetësimin se

³⁰ Për më tepër shih: Hasan Dosti, *Një jetë për çështjen kombëtare*, “Botart”, Tiranë, 2008, f. 68-74.

³¹ *The Greek minority in Albania – a documentary record (1921-1993)*, botuar nga Basil Kondis dhe Eleftheria Manda, Institute for Balkan Studies,

“të ashtuquajturit patriotë shqiptarë” po detyronin popullsinë greke të mohonte ndjenjat kombëtare. Në memorandumun grek dërguar Aleatëve Perëndimorë përmendej rasti i djegies së shtëpive të Jergucatit, një fshat i banuar nga populli me kombësi greke. Qeveria greke pretendonte se shkaku i djegies së shtëpive të Jergucatit ishte se: “banorët refuzuan të nënshkruanin deklarata të tilla (ku u kërkohej të mohonin ndjenjat kombëtare – S. B.)³²”. Memorandumi grek nuk qartëson se cilat ishin grupet, të cilat pretendoheshin se po kryenin këtë fushatë. Aty qëllimisht përmenden herë “patriotët shqiptarë”, herë partizanët shqiptarë, herë milicia shqiptare e krijuar nga pushtuesit italianë dhe herë pushtuesit italianë që, sipas memorandumit, nxinin “shovinizmin shqiptar”³³.

Situata politike e qarkut të Gjirokastrës nuk lë shkas për të menduar se grupet shqiptare të rezistencës të kishin arsye që të krijonin përplasje midis tyre dhe minoritetit grek. Në një kohë kur Aleatët e Kombeve të Bashkuara në dhjetor 1942 kishin njohur rezistencën shqiptare, grupet e rezistencës po përpiqeshin për të forcuar rezistencën, në funksion të bashkimit. Në 14 shkurt 1943, ishte arritur një marrëveshje bashkëpunimi midis LANÇ-it dhe Ballit Kombëtar³⁴. Në disa qarqe, midis tyre dhe në qarkun e Gjirokastrës, të dyja organizatat kishin zhvilluar disa aksione të përbashkëta të suksesshme kundër pushtuesit, për të cilat flitej me entuziazëm edhe në shtypin komunist të qarkut³⁵. Qoftë Balli Kombëtar, qoftë LANÇ-i nuk kishin interes të krijonin në atë moment probleme me popullsinë greke të Shqipërisë. Nga njoftimet arkivore dhe literatura ka të dhëna se në zonën e Jergucatit ishin dërguar si milicë “banorë të viseve të veriut”, për të cilët ka dëshmi për sjellje të dhunshme ndaj popullsisë së Shqipërisë së Jugut³⁶. Dokumentet që kam në dispozicion dëshmojnë që

Thessaloniki, 1994, f. 113. Ambasada mbretërore e Greqisë në SHBA për Departamentin e Shtetit, NADS, 767.75/20, 21 maj 1943.

³² *Po aty.*

³³ *Po aty.*

³⁴ M. Dezhgiu, *vep. e përm.*, f. 250.

³⁵ *AIH*, A-VIII-80, viti 1943.

³⁶ Milicia shqiptare u krijua në 18 shkurt 1943. Administrata italiane, për të ndaluar dezertimin në masë të ushtarëve-milicë dërgoi në Shqipërinë e Jugut rekrutët shqiptarë të milicisë të përzgjedhur nga zonat e Veriut të vendit dhe në krahinat e Veriut dërgoi ushtarët e rekrutuar në Jug. Ushtarët veriorë u sollën keq me popullsinë e viseve të Jugut, midis tyre edhe me popullsinë greke. Në jug të vendit u shtua dhuna, vjedhjet, grabitjet. Këtë e vërteton një komunikatë e botuar në buletin e Komitetit Qarkor të PKSH të qarkut të Gjirokastrës, në të cilën thuhet:

këto veprime të milicisë preknin mbi të gjitha popullsinë shqiptare, si myslimane ashtu dhe të krishtere. Ato nuk ishin drejtuar ndaj minoritetit dhe ndryshimit të karakterit etnik të zonës ku jetonte minoriteti.

Qeveria greke në mërgim, sipas studiuesit Riçard Glog, nuk kishte dijeni të plota për zhvillimet që ndodhnin në Greqi³⁷. Kjo të bën të mendosh se të dhënat e saj edhe për minoritetin grek në Shqipëri do të kenë qenë edhe më të pakta, ose të deformatuara. Mendoj se qeveria greke në mërgim i ngatërronte qëllimisht grupet e rezistencës shqiptare me ushtarët shqiptarë në shërbim të italianëve. Akuzat e saj ndaj Ballit Kombëtar, apo grupeve të tjera të rezistencës ishin në vazhden e linjës politike të qeverisë greke, e cila synonte krijimin e një klime dyshuese ndaj rezistencës shqiptare në kancelaritë aleate. Në këtë mënyrë, ajo kërkonte të bindte Aleatët e Kombeve të Bashkuara se kishin bërë gabim që kishin njohur rezistencën shqiptare në dhjetor 1942, pasi, sipas qeverisë greke, të gjithë shqiptarët ishin bashkëpunëtorë të pushtuesit. Qëllimi tjetër i qeverisë greke ishte të mundahej të pengonte bashkimin e të dy krahëve të rezistencës shqiptare në zonat e minoritetit.

Pavarësisht se dokumentet tregojnë për aktivitet të pakët të Ballit Kombëtar në zonën e minoritetit, në kujtimet e disa krerëve të Ballit Kombëtar, si Faik Quku, përmendet se Balli Kombëtar kishte disa përkrahës në zonën e minoritetit. Është interesant fakti se individët e pretenduar si mbështetës të Ballit, përmenden dhe si aktivistë të shoqatave Vorio-epirote në minoritet. Rasti më tipik është ai i Vasil Shahinit, njëri prej njerëzve më me influencë në zonën e minoritetit. Vasil Shahini ishte avokat i dëgjuar dhe njeri i njohur për ndjenjat e tij nacionaliste greke. Madje, shërbimi informativ shqiptar i periudhës midis dy luftërave e konsideronte si agjent të zbulimit grek³⁸. Ai ishte gjithashtu një nga themeluesit dhe aktivistët e MAVI-së. Njëkohësisht përmendet si një nga përfaqësuesit e Ballit Kombëtar për zonën e

“Në Goricë, milicë nga të Hasan Xhaferit kanë grabitur lopët dhe qetë e fshatit duke i lënë katundarët e ngratë në mjerimin më të madh”³⁶. Të njëjtin mendim mbi qëndrimin e ashpër të milicisë shqiptare në Shqipërinë e Jugut shfaq dhe studiuesi Bernd J. Fisher *Shqipëria gjatë luftës 1939-1945*, “Çabej”, Tiranë, 2004, f. 189.

³⁷ Richard Glogg, *Histori e përmbledhur e Greqisë*, botimet “Toena” & Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, Tiranë, 2004, f. 129.

³⁸ Kastriot Dervishi, *Shërbimi sekret shqiptar – historia nga fillimi deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2007, f. 166.

minoritetit³⁹. Të bën përshtypje se i njëjti njeri mund të jetë anëtar i dy organizatave me qëllime kaq të ndryshme. Kjo gjë mund të shpjegohet në dy mënyra. Mund të shkojë në mendje se midis Ballit Kombëtar dhe MAVI-së (EDES-it) të ketë pasur një marrëveshje bashkëpunimi, gjë që nga burimet e deritanishme nuk vërtetohet. Ideja tjetër është që bashkëpunimi mund të jetë në baza ideologjike, si kundërshtarë të komunistëve. Në 18 nëntor 1943, Vasil Shahini u vra nga forcat partizane në qytetin e Gjirokastrës së bashku me 11 anëtarë të Ballit Kombëtar në këtë qytet. Ky fakt e përforcon këtë ide.

Minoriteti grek: pushtimi gjerman dhe lufta civile

Nga mesi i verës së vitit 1943 situata ndërkombëtare dhe raporti i forcave ndërluftuese në Luftën e Dytë Botërore ndryshoi rrënjësisht. Disfata e ushtrisë gjermane e filluar që në shkurt 1943 në Stalingrad po vazhdonte dhe në Fronte të tjera të Luftës. Aleatët Perëndimorë kishin planifikuar se forcat ballkanike të rezistencës duhet të mbështesnin zbarkimin aleat në Ballkan. Për këtë arsye misionet britanike në Ballkanin Perëndimor bënë përpjekje që grupet rivale të rezistencës ballkanike të bashkoheshin. Me ndihmën britanike, në qershor 1943 u arrit një marrëveshje midis ELAS-it dhe EDES-it në Greqi. Për grupet e rezistencës shqiptare, procesi i filluar në shkurt 1943 me komitetin e koordinimit partizano-ballist u kurorëzua me marrëveshjen e arritur në 2 gusht 1943 në Mukje. Frymës së përgjithshme të bashkëpunimit iu përgjigj dhe minoriteti grek. Në 28 korrik 1943, në Memoraq të Delvinës u mbledhën përfaqësues të minoritetit grek që mbështesnin si FANÇ-in dhe EAM-in, ashtu dhe ata që mbështesnin EDES-in. Sipas studiuesit Uran Butka, mbledhja e Memoraqit u organizua nga Jorgo Zoto, avokat nga fshati greqishtfolës i Dhrovjanit, për të cilin autori mendon se është anëtar i Ballit Kombëtar⁴⁰. Në këtë mbledhje u vendos që të gjitha grupet brenda minoritetit do të bashkoheshin në luftë kundër pushtuesit. Për këtë u vendos të krijoheshin në minoritet katër çeta. Çështjet e tjera që shqetësonin minoritetin do të zgjidheshin pas Luftës në bazë të parimeve të Kartës së Atlantikut.

³⁹ Faik Kuku, *Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore 1939-1944*, Vëll. 2, "Ilar", Tiranë, 2006, f. 330.

⁴⁰ Uran Butka, *Lufta civile në Shqipëri 1943-1945*, "Drier", Tiranë, 2006, f. 53.

Zhvillimet e reja në rrjedhën e Luftës së Dytë Botërore, ndryshuan dhe planet e Aleatëve të Kombeve të Bashkuara për Ballkanin. Në fillim të korrikut 1943, ushtritë aleate zbarkuan në Italinë e Jugut. Në 25 korrik 1943, Musolini u detyrua të japë dorëheqjen pas një grushti shteti. Kapitullimi zyrtar i Italisë ishte çështje ditësh. Lufta e Dytë Botërore e kishte marrë drejtimin dhe fitorja e Aleatëve të Kombeve të Bashkuara ishte më shumë se një ëndërr. Kjo situatë e re i vinte forcat e rezistencës në Ballkan para dilemave dhe sfidave të reja. Për forcat e ndryshme të rezistencës si në Shqipëri, ashtu në Greqi, çështja e pushtetit politik po dilte në plan të parë.

FANÇ, në pritje të zbarkimit aleat në Ballkan, filloi të mendonte për krijimin e një qeverie provizore, e cila do t'i vinte aleatët para faktit të kryer. Në këtë kontekst, në Konferencën e Labinotit, nga 4-9 shtatori 1943, PKSH denoncoi marrëveshjen e bashkëpunimit të arritur në Mukje, duke i hapur rrugë konfliktit civil midis LANÇ dhe Ballit Kombëtar dhe nacionalistëve të tjerë që nuk pranonin të hynin në Front. Duke hedhur parullën “Gjithë pushteti këshillave nacional-çlirimtare”, në të njëjtën në konferencë u shtrua detyrë zgjerimi i Frontit duke përfshirë në të dhe “rryma të tjera”. Në mënyrë paradoksale dhe të pakuptimshme, Enver Hoxha e konsideronte dhe minoritetin grek si një rrymë të veçantë që PKSh kishte arritur ta përfshinte në FANÇ⁴¹.

Politika e adoptuar nga PKSH në Konferencën e Labinotit u diktua në një masë të madhe nga ideja e paraqitur nga PKJ, me anë të të dërguarit të saj Zvetozar Vukmanovic - Tempo për krijimin e *Shtabi të përbashkët Ballkanik*, ku do të përfshiheshin forcat e majta të rezistencës në Jugosllavi, Shqipëri, Bullgari dhe Greqi. Ky shtab do të ishte hapi i parë drejt krijimit të Federatës komuniste Ballkanike⁴², në të cilën mendohej të përfshihej dhe Greqia. Në këtë kuadër, filloi koordinimi i veprimeve midis EAM/ELAS dhe FANÇ/UANÇ. Bashkëpunimi synonte aksione të përbashkëta ndaj pushtuesit por dhe neutralizim e eliminim të grupeve kundërshtarë të rezistencës. Qëllimi i dytë ishte thelbësor për komunistët pasi do t'i siguronte rrugën drejt pushtetit. Minoritetet u konsideruan si pikat nevralgjike ku do të mbështetej bashkëpunimi, por

⁴¹ Enver Hoxha, *Dy popuj miq*, “8 Nëntori”, Tiranë, 1985, f. 13.

⁴² Për më tepër mbi idenë e hedhur nga Zvetozar Vukmanovic-Tempo për Federatën Ballkanike shih: Kristo Frashëri, *Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH-së 1878-1941, (vështrim historik me një shtojcë dokumentare)*, “Ilar”, Tiranë, 2006, f. 183-184.

dhe si parakusht për suksesin e tij. Reflektim i menjëhershëm për realizimin e projektit të bashkëpunimit ballkanik ishte mbledhja e zhvilluar në shtator 1943 në fshatin Poliçan të Gjirokastrës, një fshat me popullsi greke. Në mbledhje merrnin pjesë përfaqësues të EAM-it, të FNÇ dhe të minoritetit grek. Ashtu siç kishte vepruar me marrëveshjen e Mukjes, PKSH denoncoi marrëveshjen e Memorazit, duke e konsideruar atë të organizuar nga reaksionarë⁴³. Në takimin e Poliçanit u vendos që minoriteti grek në Shqipëri dhe ai shqiptar në Greqi të aktivizoheshin në luftën e përbashkët kundër pushtuesit. Për këtë arsye, do të krijoheshin në minoritetet përkatëse “shtabe mikse”, të cilat do të drejtoheshin nga Shtabi Përgjithshëm i vendit përkatës. Shtabi miksi i minoritetit grek do të drejtohej nga ai i Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare dhe anasjelltas. Mbledhja e Poliçanit synonte jo vetëm mobilizimin e minoritetit grek në rezistencën kundër pushtuesve, por dhe largimin e tij nga ndikimi i EDES-it. Në Shtabin Miksi minoritar merrnin pjesë i dërguar nga EAM-i, Miltiadh Kirojanis (pseudonimi i të cilit ishte Aleks Janjari S.B.), Tahir Demi i FNÇ dhe Teli Tërbaçi, përfaqësues i minoritetit grek⁴⁴.

Për një rastësi të çuditshme, në 9 shtator 1943, pikërisht ditën kur PKSH i kishte thënë jo bashkëpunimit me Ballin Kombëtar, nga zyra e Epirit të PKG arriti një letër. Kjo letër ishte përgjigje e propozimit të bërë nga Tempo për të rritur bashkëpunimin midis lëvizjeve të majta të rezistencës ballkanike. PKG e shihte të domosdoshme një bashkëpunim më të madh midis dy partive, por në të njëjtën kohë mendonte se “nuk është koha akoma që të ngrehim kryesira dhe shtatmadhorira të përbashkëta greko-shqiptare...”⁴⁵. Në po të njëjtën letër, PKG shprehej se ishte dakord për veprime të koordinuara për “organizimin e punës me minoritetet⁴⁶”. PKG ishte e kënaqur me vendimet e Poliçanit dhe premonte që do dërgonte dhe njerëz të tjerë për ta ndihmuar PKSH në punën me minoritetin grek. Letra nuk i kushtonte shumë rëndësi luftës së përbashkët kundër pushtuesit gjerman, por theksonte se bashkëpunimi duhej të shërbente që “të mos mundet reaksioni (kupto: kundërshtarët

⁴³ *Arkivi i Ministrisë së Brendshme* (më tej: *AMB*), Fondi i proceseve gjyqësore, viti 1946, dos. 1066. Nga deponimi i Teli Arbaçit në gjyqin e Gjirokastrës, qershor 1946.

⁴⁴ *Po aty*.

⁴⁵ *AQSh*, Fondi 14/AP, viti 1943, dos. 40. Letër për Zyrën e Epirit të KQ të PKSh (nëpërmjet qarkut të Gjirokastrës) nga PKG (ELAS), 9 shtator 1943.

⁴⁶ *Po aty*.

politikë) të kthejë një popull kundra tjetrit⁴⁷”. PKG pranonte propozimin e PKSH që të dërguarit e të dy partive të mos i përfaqësonin zyrtarisht ato, por të trajtoheshin si “njerëz të minoritetit të atjeshëm për me ndihmë përgjithësisht në punë⁴⁸”. Për çështjen e të ardhmes të dy minoriteteve, PKG binte dakord që popullsia “do të shprehej lirshëm pas luftës”⁴⁹.

Ndërkohë si në Shqipëri, ashtu dhe në Greqi kishin filluar përplasjet e armatosura midis grupeve rivale. Në qarkun e Gjirokastrës, ku si çetat e Ballit, ashtu dhe të FNÇ ishin të fuqishme, incidentet e para të asaj që më vonë do të shndërrohej luftë civile kishin filluar që në verë 1943. Minoriteti grek ishte gjithashtu i ndarë midis EAM/FANÇ dhe EDES. Zona e Dropullit, mbështeste më shumë ELAS-in pasi kufizohej me zonën e kontrolluar nga ai në Greqi, ndërsa minoriteti grek që jetonte në fshatrat e Sarandës mbështeste më shumë EDES-in. Incidentet e para midis Ballit Kombëtar dhe Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, ndonëse nuk drejtoheshin ndaj minoritetit, patën pasoja dhe për të⁵⁰.

⁴⁷ *Po aty*.

⁴⁸ *Po aty*.

⁴⁹ *Po aty*, Fondi 14/AP, viti 1944, dos. 52, fl. 11. Letër e Komandës së Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ shqiptare për Shtabin e Zonës I Operative Vlorë-Gjirokastrë.

⁵⁰ Në 6 korrik 1943, u vra në fshatin e banuar nga minoritarë grekë, Llongo, Thanas Ziko, komandant i njësitit gueril të zonës. Vrasësit ishin vëllezërit Biçuni nga i njëjti fshat. Shkaku i vrasjes nuk del qartë në dokumente. Në dokumente thuhet se ata pasi kanë vrarë Thanas Zikon dhe Andrea Rinon kanë sulmuar këshillin antifashist të fshatit dhe janë larguar për në Greqi. Kjo të bën të mendosh se mund të jenë vrarë për arsye politike. Në një gjyq të improvizuar, shtabi i çetave partizane dhe vullnetare në qarkun e Gjirokastrës i dënuan me vdekje vrasësit e Thanas Zikos. Zbatimi i dënimit u bë në 17 korrik 1943. Në komunikatën e Komandës së çetave partizane në krahinën e Gjirokastrës thuhej se ky ekzekutim u prit mirë nga populli minoritar, pasi tregoi “drejtësinë e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare dhe vëllazërim që duhet të kenë populli shqiptar e grek për një të ardhme dhe më të lumtur, vëllazërim që po përforcohet dita ditës në luftën kundra armikut të përbashkët, fashizmit okupator”. Gjithashtu, shumë përplasje midis FANÇ dhe Ballit Kombëtar patën ndikimin e tyre dhe në popullsinë minoritare. Në fillim të gushtit, gjatë tërheqjes së ushtrisë italiane, një çetë e Ballit Kombëtar ndër të cilët shquanin Qani Dasho, Xhafer Beqiri, Hehab Hysi etj., rrethuan në Libohovë një njësi partizane. Partizanët çanë rrethimin, por ballistët kapën 11 vetë në Libohovë, shumica të krishterë dhe ia dorëzuan armikut që i pushkatoi. Më 2 gusht, e njëjta çetë balliste udhëhoqi ushtrinë italiane në Vllaho-Goranxi, ku dogjën 3

Pushtimi gjerman i Shqipërisë e bëri të domosdoshëm bashkimin e të gjitha grupeve të rezistencës në luftë kundër tyre. Në kundërshtim me interesat kombëtare, forcat politike shqiptare filluan luftën civile. Në 1 tetor 1943, Komiteti Qendror i PKSh i dërgoi një qarkore të gjithë komiteteve qarkore të qarqeve në të cilën urdhëroi të goditen çetat e Ballit Kombëtar si “reaksionare”⁵¹. Ky urdhër shënoi nga pikëpamja formale fillimin e luftës civile në Shqipëri. Po në tetor 1943, në Greqi forcat e ELAS-it pas dështimit të mbledhjes së Kajros në gusht 1943, filluan sulmin e ri ndaj të gjithë grupeve të rezistencës, duke përfshirë këtu edhe EDES-in. FANÇ dhe PKSh, forcuan bashkëpunimin me EAM-it dhe bënë lëvizjen tjetër në minoritetin grek. Në nëntor 1943 në Konispol u zhvillua një mbledhje e përfaqësuesve të minoritetit grek. Mbledhja ritheksoi vendimet e marra në Poliçan. Në fund të vitit 1943, sipas direktivave të PKSH u thirr Konferenca e Arsimitarëve të minoritetit, e cila afirmoi të drejtën e minoritetit grek për të përdorur gjuhën greke në jetën e përditshme, në arsim dhe në administratë. Kjo ishte një lëvizje e zgjuar e PKSH dhe kishte qëllim të bënte për vete “arsimtarët e minoritetit që janë shumica zervista”⁵². Nga ana tjetër, Konferenca lejoi që “në shkollat grekofone do të këndohet si himn i përgjithshëm vetëm ai i Këshillit të përgjithshëm të EAM-it”⁵³. Ky vendim synonte t’i shkëpuste minoritarët grekë nga idetë irredentiste që përhapnin njerëzit e Zervës dhe nga ana tjetër t’i afronte ata ideologjikisht me komunistët. Vendimet e marra në konferencën e arsimtarëve të minoritetit krijuan një klimë besimi midis Frontit Nacionalçlirimtar dhe minoritetit grek. Rezultati më i qartë i kësaj klime ishte krijimi, në 26 nëntor 1943, i batalionit “Thanas Ziko”, i përbërë nga minoritarë grekë.

shtëpi dhe vranë 3 vetë. Po kështu në fshatin Glinë u vranë 27 vetë, ndër ta 12 -15 vjeçarë. Të gjitha këto veprime i dhanë shkas PKSH që në 12 shtator 1943 të shpërndante një trakt në Gjirokastrë ku fajësonte anëtarët e Ballit Kombëtar: “Programi i Ballit flet për luftë okupatorit e disa nga të Ballit jo vetëm që s’i bëjnë luftë fashizmit, por e mbajnë popullin larg luftës; programi i Ballit flet se ka në Balli elementa që jo vetëm sjellin përçarje, por dhe venë gjer në vëllavrasje” shih: *AIH*, A-VIII-80, viti 1943.

⁵¹ *Dokumente kryesore të PPSH ...*, f. 210-215.

⁵² *AQSh*, Fondi 14/AP, viti 1944, dos. 94, fl. 4. Raport i Koço Tashkos drejtuar Enver Hoxhës, mbi punën në Qarkun e Gjirokastrës, 14 shtator 1944.

⁵³ *Po aty*.

Në dhjetor 1943, filloi në zonën jugore dhe qendrore të Shqipërisë një operacion në shkallë të gjerë i pushtuesve gjermanë. Operacioni shkaktoi shpërndarjen e përkohshme të formacioneve ushtarake partizane. Disfata e Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare zbehu mbështetjen e popullit për të. Popullsia e Delvinës dhe e fshatrave përreth, edhe ajo minoritare që deri atëherë kishin mbështetur Lëvizjen Nacionalçlirimtare ishte bashkuar me Ballin Kombëtar⁵⁴.

Në shkurt 1944, nën presionin britanik, EAM-i dhe EDES-i në Greqi u detyruan të nënshkruajnë një marrëveshje bashkëpunimi. EAM-i, nën presionin e opinionit publik grek u detyrua të përfshijë në programin e tij çështjen e kufijve⁵⁵. Këto ngjarje patën reflektim të menjëhershëm në rezistencën e minoritetit grek. EDES-i dhe EAM-i i bënë thirrje përkrahësve të tyre në minoritet që “të bashkoheshin me partinë më të fortë dhe të mos luftonin”⁵⁶. Ndryshimi i politikës së EAM-it solli si rezultat të menjëhershëm kërkesën që Shtabi Miks i krijuar për minoritetin, të zëvendësohej me një shtab plotësisht minoritar, që vepronte i pavarur. Duke përfituar nga konfuzioni që krijoi operacioni i pushtuesve dhe mungesa e vëmendjes së shtabit shqiptar të Zonës I Operative, të dërguarit e EAM-it për të organizuar rezistencën e minoritetit grek, krijuan një situatë të rrezikshme për integritetin territorial të shtetit shqiptar. Komiteti qarkor i qarkut të Gjirokastrës ankohej për veprimtarinë e Aleks Janjarit në krahinat minoritare. Ata theksonin se ai punonte në minoritet “në formë bajraktarllëku” dhe se e kishte bërë minoritetin t’i drejtonte sytë nga Greqia. Peço Kagjini, anëtar i komitetit qarkor të Gjirokastrës shprehte shqetësimin se veprimtaria e përfaqësuesve të EAM-it kishte bërë që minoriteti grek të kërkonte bashkim me Greqinë. Në një miting në krahinën e Dhrovjanit “u ngrit një dhe tha se ne pranojmë të jemi në një Greqi qoftë komuniste, qoftë djalliste, por vetëm në Greqi të jemi⁵⁷”. Kjo politikë e re shkëputëse dhe pritëse e emisarëve të EAM-it kishte shkaktuar pasivitet në rezistencën e

⁵⁴ *Po aty*, dos. 115, fl. 3. Letër e komitetit qarkor të Gjirokastrës për KQ të PKSH, 23 mars 1944.

⁵⁵ *Po aty*, A-V-159. Koleksion i Dokumenteve Britanike, Studim i Departamentit të Kërkimeve të Forin Ofis (Foreign Office), 30 qershor 1944.

⁵⁶ *Po aty*, Fondi 14/AP, viti 1944, dos. 115, fl. 3. Letër e komitetit qarkor të Gjirokastrës për KQ të PKSH, 23 mars 1944.

⁵⁷ *Po aty*, Fondi 14/AP strukturë, viti 1944, dos. 115, fl. 10. Letër e komitetit qarkor të Gjirokastrës për KQ të PKSH, 14 maj 1944.

minoritetit grek. Koço Tashko, i dërguari i KQ të PKSh në Zonën I Operative ngrinte me forcë shqetësimin se gjatë dimrit 1943-1944, formacionet ushtarake të minoritetit jo vetëm nuk luftonin kundër pushtuesit, por dhe ishin “bërë barrë në kurriz të popullsisë së thjeshtë”⁵⁸. Koço Tashko, krahas veprimtarisë së emisarëve të EAM-it ngarkonte me përgjegjësi dhe shtabin shqiptar, i cili “nuk ishte interesuar për të (batalionin Thanas Ziko S.B.)”⁵⁹. Pasi Koço Tashko ia kishte raportuar çështjen Bedri Spahiut, komandantit të Zonës I Operative, ai shkarkoi anëtarët e shtabit të batalionit Thanas Ziko dhe e bashkoi atë me batalionin shqiptar Thoma Lulo.

Në 2 prill 1944, Enver Hoxha i shqetësuar nga gjendja në minoritetin grek i dërgoi një letër PKG. Ai mendonte se kishte ardhur koha që të bëhej një takim ndërmjet përfaqësuesve të dy partive. Sipas E. Hoxhës takimi ishte i “nevojshëm dhe urgjent për të diskutuar mbi çështje të ndryshme që na përkasin dhe sidomos çështjen e minoriteteve⁶⁰”. Enver Hoxha i kërkoi të dërgohen njerëz, të cilët të punojnë për “vëllazërimin e popujve tanë” dhe pranoi që ishin bërë gabime si nga shokët tanë, ashtu dhe nga shokët grekë që punonin së bashku me minoritetin grek në Shqipëri⁶¹. Duke pasur frikë se marrëveshja midis EAM-it dhe EDES-it mund të shkaktonte ndërhyrjen e kësaj të fundit në zonën e minoritetit, PKSH u shpreh fare qartë se nuk do të lejonte që marrëveshja e bashkëpunimit midis EAM-it dhe EDES-it të shtrihej dhe në minoritetin grek⁶². Pas kësaj, PKG tërhoqi Aleks Janjarin nga zona e minoritetit dhe dërgoi përfaqësues të tjerë për të ndihmuar në organizimin e rezistencës së minoritetit grek. Gjithashtu, u dërguan dy oficerë të EAM-it për batalionin “Thanas Ziko”⁶³.

Në fillim të vitit 1944, Balli Kombëtar ndryshoi politikën në lidhje me rezistencën ndaj pushtuesit. Pas Kongresit të Beratit, në 3 janar 1944, ai e vlerësoi komunizmin si një rrezik real dhe të madh për kombin dhe çështjen kombëtare. Nacionalistët mendonin se komunistët shqiptarë, për

⁵⁸ *Po aty*, Fondi 14/AP, viti 1944, dos. 94, fl. 1. Raport i Koço Tashkos për Enver Hoxhën, mbi punën në Qarkun e Gjirokastrës, 14 shtator 1944.

⁵⁹ *Po aty*.

⁶⁰ E. Hoxha, *vep. e përm.*, f. 18.

⁶¹ *Po aty*.

⁶² *Po aty*.

⁶³ *AIH*, A-VIII-80. Komunikatë e FNÇ për qarkun e Gjirokastrës, 24 korrik 1943.

shkak të lidhjeve të tyre me komunistët jugosllavë, nuk do të mbështesnin bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Për të parandaluar këtë gjë, Balli Kombëtar zbuti qëndrimin edhe ndaj grupeve politike jokomuniste greke dhe u përpoq të vendoste kontakte dhe të arrinte një marrëveshje me forcat e djathta politike greke. Në fillim të vitit 1944, kryetari i Ballit Kombëtar, Mit'hat Frashëri dërgoi në Greqi gazetarin Dhimitër Fallo për t'i propozuar palës greke një marrëveshje. Dokumentacioni dhe literatura që kam në dispozicion nuk jep të dhëna shumë të qarta për këtë marrëveshje. Ka një mospërputhje midis dokumentacionit dhe literaturës në lidhje me iniciatorët e marrëveshjes. Ministri i Jashtëm i qeverisë shqiptare në kohën e pushtimit gjerman, Bahri Omari, pohon se qeveria shqiptare i ishte përgjigjur një propozimi të palës greke për krijimin e një federate greko-shqiptare. Në kujtimet e Athanasios Krisohut, përfaqësuesit të qeverisë së Athinës në Maqedoninë greke, jepen të dhëna më të plota për bisedimet midis tij dhe Dhimitër Fallos, por është e vështirë të vërtetohet autenticiteti i të gjitha pohimeve të tij. Sipas Krisohut, propozimi për një marrëveshje shqiptaro-greke ishte bërë nga pala shqiptare. Nacionalistët shqiptarë ishin më të interesuar për një marrëveshjeje. Krijimi i një federate, apo konfederate greko-turko-shqiptare, në këndvështrimin e tyre do ta parandalonte rrezikun komunist, apo pansllavizmin në Ballkan. Kjo vërtetohet dhe nga fakti që në të njëjtën kohë kur Dhimitër Fallo bëri kontaktet e para me personalitetet lokale greke, Rakiq Frashëri, djali i Mehdi Frashërit u dërgua në Turqi me një propozim të ngjashëm⁶⁴.

Misioni i Dh. Fallos filloi në shkurt 1944. Sipas kujtimeve të Krisohut, menjëherë pas mbërritjes në Selanik, Dh. Fallo u takuar me Aleksandër Orollogan, një gazetar grek, i cili kishte pranuar të bëhej ndërmjetësi midis tij dhe Fallos. Në javën e parë të shkurtit 1943, u zhvillua takimi i parë jo zyrtar mes Krisohut dhe Fallos. Fallo i paraqiti A. Krisohut një dokument të hartuar në shqip dhe të përkthyer në frëngjisht, sipas të cilit Dhimitër Fallo paraqitej si i dërguari zyrtar i qeverisë shqiptare⁶⁵. Fallo e njoftoi Krisohun se në Tiranë ishte krijuar tashmë një Shoqatë shqiptaro-greke, në të cilën merrnin pjesë "shqiptarët më të njohur", të cilët kishin pranuar idenë e një shteti dualist greko-

⁶⁴ Beqir Meta, *Tensioni greko-shqiptar (1939-1949)*, "GEER", Tiranë, 2002, f. 127.

⁶⁵ Basil J. Photos, *Lost opportunities for Greek-Albanian rapprochement*, Euclid Publishing Company Prospect Heights, Illinois, 1997, f. 83.

shqiptar me të drejta të barabarta⁶⁶. Arsyetimi i Fallos ishte se një federatë e tillë ishte e dobishme si për Shqipërinë ashtu dhe për Greqinë. Shqipëria, në opinionin e Fallos, ishte një shtet i vogël dhe i paaftë të vetekzistonte pa ndihmën e një shteti tjetër. Në mënyrën se si po rridhnin punët, dukej se Fronti pansllav në Ballkan po rritej, i vetmi shpëtim ishte që Greqia, Shqipëria dhe Turqia si shtetet jo sllave të Ballkanit duhet të bashkoheshin⁶⁷. Projekti shqiptar pranonte si kufij jugorë ato të 1939-ës, ndërsa kërkonte mbështetjen greke për përfshirjen e Kosovës dhe tokave shqiptare në zonën e Dibrës në shtetin shqiptar të pasluftës. Në lidhje me çështjen e minoriteteve, në projekt parashikohej që ato të shiheshin “si mjet afrimi mes dy palëve dhe jo mjet largimi. Ta kini ndërmend se minoritetet duhen t’i kqyrin mirë të dyja palët dhe të kenë të drejtat e tyre⁶⁸”.

Për Krisohun pala shqiptare duhet të plotësonte dy kushte paraprake, në mënyrë që ai t’i paraqiste këtë propozim qeverisë së tij. Kushti i parë ishte që pala shqiptare të pranonte “dorëzimin e Vorio Epirit⁶⁹”. Kushti i dytë lidhej me ndalimin, sipas Krisohut, të persekutimit të minoritetit grek. Për kushtin e parë, Fallo premtoi se do ta diskutonte çështjen me anëtarë të komitetit shqiptaro-grek dhe qeverinë shqiptare. Në lidhje me çështjen e persekutimit të minoritetit grek, Fallo sqaroi se minoriteti grek në Shqipëri nuk pësonte asnjë persekutim. Ai i sqaroi Krisohut gjerë e gjatë, situatën politike në Shqipërinë e Jugut. Lufta civile midis komunistëve dhe nacionalistëve e kishte ndarë jugun e vendit dhe popullsia po pësonte dëme të shumta për shkak të saj. Minoriteti grek ishte gjithashtu i ndarë mes komunisteve dhe nacionalistëve dhe po pësonte dëme si pasojë e përfshirjes në luftën civile shqiptare.

Në 7 shkurt 1944, ish-kryeministri gjatë monarkisë, Koço Kota, shkoi në Selanik nga Athina, ku ishte vendosur pas pushtimit italian të Shqipërisë. Sipas kujtimeve të Krisohut, ai ishte caktuar nga qeveria shqiptare si kryetar i komitetit greko-shqiptar dhe një nga negociuesit e bashkimit shqiptaro-grek⁷⁰. Në deponimet e tij në gjyqin special, Koço Kota nuk pranon të ketë qenë kryetar i delegacionit, por një pjesëmarrës

⁶⁶ Për tekstin e plotë të projektit shqiptar shih: B. Meta, *vep. e përm.*, f. 124.

⁶⁷ Basil J. Photos, *vep. e përm.*, f. 88.

⁶⁸ B. Meta, *vep. e përm.*, f. 125.

⁶⁹ Basil J. Photos, *vep. e përm.*, f. 88.

⁷⁰ *Po aty*, f. 91.

në bisedime si person privat, madje ai ka mohuar të ketë përfaqësuar në bisedime Partinë e Legalitetit⁷¹.

Në 8 shkurt 1944, Koço Kota, Dhimitër Fallo, Kostandin Godi, Selim Mborja u takuan në shtëpinë e këtij të fundit, me Krisohun dhe Aleksandër Orollogën. Të nesërmen, Athanasios Krisohu përpiloi një raport të hollësishëm mbi bisedimet e zhvilluara dhe ia dërgoi atë qeverisë së Ralisit. Ai njoftonte qeverinë e tij se kërkesat e përfaqësuesve shqiptarë ishin: “Kombi shqiptar mund të drejtohej drejt këtij bashkimi për sa kohë që dinjiteti dhe krenaria e tij nuk prekeshin. Në këtë mënyrë, dispozitat në të cilat ishte i mundur bashkimi ishin këto:

- a) Një komb i unifikuar me pavarësi lokale në lidhje me administratën, drejtësinë, edukimin dhe autoritetin politik.
- b) Politikë të jashtme të unifikuar me atë të Greqisë.
- c) Mbrojtje kombëtare të unifikuar me një ushtri nën ministrinë e luftës së Athinës
- d) Një politikë ekonomike të unifikuar me atë të Greqisë dhe heqjen e tatimeve doganore midis dy vendeve”⁷².

Përfaqësia shqiptare kishte kujtuar gjithashtu se të dy shtetet janë nën të njëjtin pushtim gjerman dhe që të ketë sukses bashkimi duhet të ndërmerren aksione të përbashkëta kundër gjermanëve⁷³. Të bën përshtypje që në raportin e dërguar nga Krisohu për qeverinë greke të Ralisit, nuk është përmendur çështja e “Vorio Epirit”. Kjo të bën të mendosh që në këtë takim të dytë, kjo çështje nuk është trajtuar fare. Raporti i Krisohut ju shpërnda dhe partive të tjera greke, si dhe qeverisë greke në mërgim. Kryeministri Ralis, sipas Krisohut, u shpreh i gatshëm për të vazhduar bisedimet, ndërsa forcat e tjera politike të Greqisë, si dhe qeveria greke në mërgim u treguan shumë skeptikë për propozimin shqiptar për sa kohë që ai nuk parashikonte bashkim të “Vorio-Epirit” me Greqinë.

Për t’i dhënë bisedimeve karakter zyrtar, në mes të majit 1944, nga qeveria e Tiranës dërgohet si anëtar i delegacionit Xhavit Leskoviku, ish ministri shqiptar në Athinë dhe Berlin. Ai dhe shqiptarët e tjerë bënë bisedime me disa nga drejtuesit e partive greke. Në bisedime nuk merrnin

⁷¹ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (më tej: MPB), Fondi i proceseve gjyqësore, viti 1945, dos. 1568. Nga deponimi i Koço Kotës në Gjyqin Special.

⁷² B. J. Photos, *vep. e përm.*, f. 93.

⁷³ *Po aty.*

pjesë as përfaqësues të EDES-it, as ata të EAM-it. Për çështjet e trajtuara në këto bisedime në arkivat shqiptare nuk ka informacion të mjaftueshëm. Në gjyqin special thuhet se në 17 qershor 1944, Xhavit Leskoviku i ka dërguar Bahri Omarit një raport për t'i shpjeguar fazën e bisedimeve dhe kërkon instruksione brenda 41 ditëve për çfarë duhet bërë me partitë greke⁷⁴, në lidhje me zhvillimet e bisedimeve greko-shqiptare. Ky raport, megjithëse përmendet shkarazi në procesverbalet e gjyqin nuk gjendet së bashku me dokumentet e tjera në dosjen gjyqësore⁷⁵. Nga deponimet e Xhavit Leskovikut kuptohet se në letrën e tij është përmendur Vorio-Epiri, gjë që të bën të mendosh që bisedimet kanë ngecur pikërisht në këtë pikë⁷⁶. Pas bisedimeve të majit, çështja mbeti pezull në pritje të miratimit të bisedimeve nga përfaqësuesit e ndryshëm të politikës greke. Presioni i palës greke ishte t'u merrnin premtimin shqiptarëve se në shtetin dualist territoret e Shqipërisë së Jugut të kërkuara nga grekët do të bashkoheshin me njësinë greke, gjë që ishte e papranueshme për palën shqiptare. Kështu, pretendimet territoriale greke ndaj Shqipërisë u bënë dhe njëherë shkaku kryesor i dështimeve të bisedimeve greko-shqiptare.

Nga ana tjetër, dëshira e shqiptarëve për të bërë pjesë të kësaj federate dhe Turqinë, sado që ishte një lëvizje e zgjuar, ishte utopike. Bashkërendimi i qëndrimeve të përbashkëta ndërmjet Greqisë dhe Turqisë për një (Kon)federatë të përbashkët Shqipëri-Greqi-Turqi ishte një kapitull më vete po aq i ndërlikuar (në mos më shumë) sa ai shqiptaro-grek. Gjithashtu bashkimi i Shqipërisë me Turqinë paralajmëronte më tepër për një dobësi të pozitës së Greqisë brenda (kon)federatës se sa forcim të saj, gjë që e bënte të pamundur pranimin e idesë nga Greqia. Ndikim jo të vogël në dështimin e bisedimeve patën dhe ngjarjet e ndodhura në të dy vendet në pranverë-verë 1944.

Ndërkohë që zhvilloheshin bisedimet mes shqiptarëve dhe grekëve, situata në Shqipëri bëhej dhe më e vështirë. Lufta civile midis Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe çetave të Ballit Kombëtar po bëhej më e ashpër, duke e komplikuar kështu rezistencën shqiptare kundër pushtuesit gjerman. Në prill-maj 1944, pushtuesit gjermanë filluan një operacion të ri kundër forcave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Sipas

⁷⁴ *AMB*, Fondi i proceseve gjyqësore, viti 1945, dos. 1568. Nga deponimi i Xhavit Leskovikut në Gjyqin Special.

⁷⁵ *Po aty*. Nga deponimi i Bahri Omarit në Gjyqin Special.

⁷⁶ *Po aty*. Nga deponimi i Xhavit Leskovikut në Gjyqin Special.

raporteve të komitetit qarkor të PKSH të qarkut të Gjirokastrës, këto operacione kishin pasur pasoja të rënda për qarkun. Pushtuesit gjermanë në vijim të politikës së tyre për t'i lënë shqiptarët të luftonin me njëri-tjetrin, kishin lënë çetat e Ballit Kombëtar të luftonin kundër fshatrave minoritare mbështetëse të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar. Komiteti qarkor i Gjirokastrës shprehte shqetësim për këtë lojë të rrezikshme të luajtur nga pushtuesit gjermanë se "këto veprime barbare u bënë në tre fshatrat e minoritetit duke djegur dhe duke vrarë njerëz që s'kanë marrë pjesë dhe janë sjellë urtë (ushtarët gjermanë S. B.), ndërsa veprimet i kanë bërë ballistët⁷⁷". Kjo kishte ndikuar që qarqet më nacionaliste brenda minoritetit grek të shpreheshin për situatën se "shqiptarët me njëri-tjetrin s'e prishin kurrë, por të gjitha kopaçet bien mbi kurrizin e popullit minoritar"⁷⁸.

Operacioni i dytë gjerman nuk pati të njëjtin rezultat me të parin. Forcat komuniste kishin fituar epërsi të dukshme në luftën e brendshme dhe po ndërmerrnin hapat për instalimin e pushtetit të tyre dhe regjimit komunist. Kongresi i Përmetit, i mbajtur në maj 1944, shënoi hapin më të rëndësishëm në marrjen e pushtetit prej komunistëve dhe në forcimin e luftës së tyre ndaj kundërshtarëve politikë. Largimi i trupave gjermane nga zonat jugore të vendit i dha fund rezistencës në zonat jugore shqiptare midis tyre dhe asaj të minoritarëve grekë. Në këto zona forcat partizane vazhduan të forconin pushtetin e tyre dhe të merrnin masa për të eliminuar kundërshtarët politikë. Në qershor 1944, pas urdhrin të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, qeveria provizore shqiptare shpalli mobilizimin e përgjithshëm të popullsisë në zonat e çliruara. Ndër to ishte dhe zona ku jetonte minoriteti grek. Njësitë minoritare u dërguan së bashku me forcat e tjera të ushtrisë shqiptare të luftojnë në veri të vendit.

⁷⁷ *AQSh*, Fondi 14/AP strukturat, viti 1944, dos. 115, fl. 10. Letër e Komitetit qarkor të Gjirokastrës për KQ të PKSH, 14 maj 1944.

⁷⁸ *Po aty*.

*S u m m a r y*THE GREEK MINORITY IN ALBANIA BETWEEN THE ALBANIAN
RESISTANCE AND THE GREEK ONE (1942-1944)

The article aims to present an overview of the endeavours of the resistance groups against the Italian and the German invaders in Albania and Greece to include the Greek minority. All of them tried to have the Greek minority on their side in their resistance against the invaders although for different reasons. For the Albanian resistance groups the inclusion of the Greek minority had special importance because they were Albanian citizens as well as an integral part of the Albanian state. For the Greek ones the resistance of the Greek minority would have been precondition to secure the right of self-determination. This would have secured the support of future Allies in the United Nations for the Greek claims toward the “Northern Epirus”.

The republican forces of EDES were the first to make the efforts to include the Greek minority in the resistance against the invader. However, the National Liberation Front helped by Greek EAM was successful in engaging the Greek minority against the invader. The reason should be found on the internationalist agreements of the two resistance groups of the left wing in Albania and in Greece. The right wing groups of resistance made efforts to achieve an agreement between them. But they were obstructed by the Greek territorial claims toward Albania.

